



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Sociologji

Varianti A

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• *Pyetjet me zgjedhje*

Numri i Pyetjes	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Përgjigja e saktë	B	D	B	C	A	C	B	A	D	B

• *Pyetjet me zhvillim*

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin

1. B) vëzhgim jopjesëmarrës;
2. D) simbol kulturor;
3. B) shoqërizimit;
4. C) teorisë sociologjike të Trevis Hirsh;
5. A) endogame;
6. C) asimilimi;
7. B) shekullarizimi;
8. A) lëvizshmëri shoqërore;
9. D) eksurbanizim;
10. B) moderne.

11. Model përgjigjeje:

- a) një sistem pyetjesh, të lidhura logjikisht rreth një problemi të caktuar.
- b)

1. shkalla e njëfarë homogjeniteti relativ të grupit të njerëzve që studiohet(sa më “homogjen” të jetë grupimi shoqëror që studiohet, aq më i vogël llogaritet kampioni dhe anasjelltas)
2. niveli i ndërlikimit të problemit që studiohet(sa më i ndërlikuar të jetë problemi që studiohet, aq më i zgjeruar lipset kampioni dhe anasjelltas)

3 pikë Nëse shkruan saktë përkufizimin për anketën sociologjike dhe dy kritetret e kampionimit

OSE

- 2 pikë** Nëse shkruan saktë përkufizimin për anketën sociologjike dhe një kriter të kampionimit
1 pikë Nëse shkruan përkufizimin për anketën sociologjike
1 pikë Nëse shkruan një kriter kampionimi
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

12. Model përgjigjeje:

Keqkuptimi mes kulturave për shkak të ndryshimit në:

- a) Vlerësimi dhe gjykimi i një kulture nga kritere të një kulture tjetër
- vlera kulturore mes anëtarëve të kulturave të ndryshme (p.sh., vlerave kulturore shqiptare në dallim nga vlerat kulturore të vendeve të tjera si: respektimi i besës, fjalës së dhënë si vlerë kulturore shqiptare, përkundrejt kontratës së shkruar si rregull në shtetet e tjera), etj.,
 - simbolet e ndryshme kulturore (p.sh., shfaqja hapur ose jo, e gjendjes emocionale dhe shpirtërore/ veshjet me kuptime simbolike si: veshjet popullore/ veshjet e ceremonisë së zisë/të martesës etj.)
 - mendësi dhe praktika për të justifikuar politika të caktuara, sidomos dështimet e saj, si psh në sistemin komunist në Shqipëri, politizimi i artit dhe kulturës, arsimit, shtypit, deri tek urimet dhe këngët në dasma për partinë, etj.
 - vlerësimi sipas kritereve të kulturës politike shqiptare, të të gjitha kulturave të vendeve të tjera, duke ngritur lart vlerat e kulturës në socializëm dhe duke quajtur si dekadente, të degjeneruara të gjitha vlerat kulturore të shteteve të tjera kapitaliste, etj.,
 - të tjera.
- b) Mbivlerësimi i kulturave të vendeve të tjera dhe nënvlerësimi i kulturës vetjake
- emigrantët shqiptarë në fillimet e qëndrimit në vende të tjera, e nënvlerësonin kulturën shqiptare duke parë anët më të paarrira të saj dhe duke hedhur poshtë gjithçka pozitive dhe kombëtare, si p.sh.:
 - në mënyrën e jetesës;
 - në etikën e komunikimit mes njerëzve;
 - në mobilimin e shtëpive;
 - në art dhe muzikë (p.sh. u vlerësuan shumë rryma muzikore të huaja, duke nënvleftësuar muzikën popullore dhe atë të lehtë me motive kombëtare) etj.
- 4 pikë** Nëse shkruan katër shembuj - nga dy për secilën mënyrë vlerësimi të kulturës
OSE
3 pikë Nëse shkruan tre shembuj;
2 pikë Nëse shkruan dy shembuj;
1 pikë Nëse shkruan një shembull;
0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

13. Model përgjigjeje:

a)

1. shoqërizimi i seks-roleve;
2. përcaktuese statuseshe;
3. vijimësi nga prindërit te fëmijët (profesionet/statusin shoqëror/modele sjelljesh)

b)

1. zgjerimi i ndërveprimeve me të tjerët;
2. aftësimi intelektual dhe profesional;
3. edukimi me rregulla;
4. mirëintegrimi në shoqëri, etj.

4 pikë Nëse shkruan katër momente - nga dy për secilën agjenci shoqërizimi;

3 pikë Nëse shkruan tre momente;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy momente;

1 pikë Nëse shkruan një moment;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

14. Model përgjigjeje:

- a) Mendimi dhe veprimi nuk është devijues në vetvete. Ai vlerësohet si deviant në raport me vlerat dhe normat e një kulture të caktuar.
1. Vlerësimi i abortit si sjellje deviante ose jo në shoqëri të ndryshme.
 2. Pirja e alkoolit si sjellje deviante në kultura të ndryshme etj.

- b) Një veprim mund të quhet deviant ose jo edhe nga rrethana të veçanta shoqërore.
1. Vrasja e një njeriu në kushte paqeje është krim. Vrasja e pushtuesit të vendit tënd në kushte lufte të drejtë nuk quhet e tillë. Ajo nderohet si akt heroik.
 2. Në regjimin komunist dënohej çdo njeri që bënte propagandë anti parti-shtet.
 3. Gjakmarrja në krahina të ndryshme të vendit tonë ishte një detyrim për meshkujt e rritur të familjes/quhej sjellje tradicionale/Sot ajo dënohet me ligj si krim i rëndë, etj.
- c) Disa sjellje trajtohen si deviante ose jo nisur nga pozita shoqërore e mbartësit të tyre:
1. Përkrahen njerëzit më të privilegjuar në pasuri
 2. Përkrahen njerëzit më të privilegjuar në pushtet
 3. Përkrahja e njerëzve me profesione të veçanta, etj.

3 pikë Nëse shkruan tre shembuj për secilën kërkesë mbi sjelljen deviante;

OSE

2 pikë Nëse shkruan dy shembuj;

1 pikë Nëse shkruan një shembull;

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

15. Model përgjigjeje:

- diskriminim për vajzat/gratë në raport me djemtë/burrat

a)

▪ paga të pabarabarta për punë të barabarta

- arsimim më shumë dhe punësim më pak
- pozicione pune me status të ulët vlerësimi
- të ardhura më të pakta nga punësimi
- punësimi në profesione më pak fitimprurëse
- preferenca për të punësuar meshkujt
- superioriteti i meshkujve në pozicione drejtuese
- seksizmi në punë, etj.

b)

- status më i ulët në të drejta
- ngarkesë e madhe fizike
- ngarkesë më e madhe emocionale
- status jo i barabartë në vendimmarrje
- autoriteti më të ulët përballë fëmijëve
- pamundësia për karrierë për shkak të angazhimit në punët e shtëpisë dhe mirërritjen e fëmijëve
- të dhunuara

c)

- zbutin vrazhdësinë dhe vulgaritetin e krijuar nga disa politikanë meshkuj
- nxitin një komunikim më të kulturuar
- janë më pak të korruptueshme
- janë më të ekuilibruara në bindjet politike
- janë më të përgjegjshme për detyrat etj.

- **4 pikë** Nëse shkruan aspekte të pabarazisë gjinore përkatësisht:

-një në punësim dhe të ardhura

-një në familje

si dhe dy pasoja pozitive të përfshirjes së grave në politikë.

- **OSE**

- **3 pikë** Nëse shkruan aspekte të pabarazisë gjinore përkatësisht:

-një në punësim dhe të ardhura

-një në familje

- si dhe një pasojë pozitive të përfshirjes së grave në politikë.

- **3 pikë** Nëse shkruan aspekte të pabarazisë gjinore përkatësisht:

-një në familje

- si dhe dy pasoja pozitive të përfshirjes së grave në politikë.

- **3 pikë** Nëse shkruan aspekte të pabarazisë gjinore përkatësisht:

-një në punësim dhe të ardhura.

- si dhe dy pasoja pozitive të përfshirjes së grave në politikë.

- **2 pikë** Nëse shkruan aspekte të pabarazisë gjinore përkatësisht:

-një në punësim dhe të ardhura

- një në familje.
- **2 pikë** Nëse shkruan dy pasoja pozitive të përfshirjes së grave në politikë
- **2 pikë** Nëse shkruan një pabarazi në punësim dhe një pasojë
- **2 pikë** Nëse shkruan një pabarazi në familje dhe një pasojë
- **1 pikë** Nëse shkruan:
 - një aspekt të pabarazisë gjinore në punësim OSE
 - një aspekt të pabarazisë gjinore në familje OSE
 - një pasojë pozitive të përfshirjes së grave në politikë
- **0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

16. Model përgjigjeje:

Mundësi të barabarta në shoqëri për të gjithë grupet racore ose etnike në:

- a) shkollim
 - a' Mbrojtja me ligj e të drejtës për arsimim në gjuhën amtare. Gjuhën e vendit ku jetojnë e mësojnë si gjuhë të huaj;
 - a'' shembull: minoriteti grek në Shqipëri ka të drejtë të përdorë simbolet e veta kombëtare, të festojë ditët zyrtare të rëndësishme për kombin e tij, ashtu si në vendin ku jeton shumica e popullsisë.
- b) Mbrojtja me ligj e të drejtës për marrëdhënie të drejta, pa konflikte ndër racore dhe ndëretnike, etj., për:
 - punësim;
 - karrierë profesionale dhe shoqërore;
 - ruajtjen e identitetit kulturor;
 - zhvillimin i kulturës së vendit të origjinës;
 - ruajtjen e identitetit kombëtar.
- c) të gjitha grupet racore ose etnike kanë mundësi të barabarta në shoqëri – ligjet në SHBA- shumica e zbatojnë pluralizmin si përpjekje për të zhvilluar ato anë të kulturës, të identitetit racor ose etnik, që nuk i pengon të përfshihen në veprimtaritë e mundshme politike, ekonomike etj.

4 pikë Nëse:

- gjen dy aspekte të kërkuara
- sqaron secilin aspekt të zgjedhur të marrëdhënieve të barabarta mes shumicës dhe pakicës etnike, në shoqërinë modernë.

OSE

3 pikë Nëse:

- gjen dy aspekte të kërkuara
- sqaron vetëm njërin aspekt të zgjedhur të marrëdhënieve të barabarta mes shumicës dhe pakicës etnike, në shoqërinë moderne.

2 pikë Nëse:

- gjen një aspekt të kërkuar
- sqaron secilin aspekt të zgjedhur të marrëdhënieve të barabarta mes shumicës dhe pakicës etnike, në shoqërinë modernë.

1 pikë Nëse:

gjen vetëm njërin aspekt

OSE

sqaron vetëm njërin aspekt

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

17. Model përgjigjeje:

- a)
 - Pushtimet e shumta nga shtete të fuqishme të kohës;
 - Ndikimi i larmishmërisë fetare të shteteve fqinjë.
- b)
 - Vlera e theksuar kulturore e shqiptarëve për mikpritjen dhe fjalën e dhënë;
 - Vënia e idealit kombëtar mbi atë fetar përballë planeve përçarëse të pushtuesve ;
 - Marrëdhëniet e ngushta me njëri-tjetrin në një vend të vogël;
 - Izolimi nga kontaktet me kultura të tjera pas Luftës së Dytë Botërore;
 - Edukimi ateist gjatë disa dekadave të sistemit socialist;

2 pikë Nëse shkruan:

- një arsye që në Shqipëri ekzistojnë disa besime fetare;
- një arsye që në Shqipëri ka bashkëekzistencë paqësore të besimeve të ndryshme fetare.

OSE**1 pikë** Nëse shkruan:

- një arsye që në Shqipëri ka ekzistencë të disa besimeve fetare

1 pikë Nëse shkruan:

- një arsye që në Shqipëri ka bashkëekzistencë paqësore të besimeve të ndryshme fetare

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

18. Model përgjigjeje:

Qyteti/Fshati

- a) Masa e madhe/vogël e popullsisë;
- b) Vendbanim i dendur/rrallë;
- c) Shumëllojshmëria/njëtrajtshmëria shoqërore;
- d) Popullsi heterogjene/homogjene;
- e) Toleranca/intoleranca ndaj ndryshimeve shoqërore dhe kulturore;
- f) Njohje të sipërfaqshme/të thella;
- g) Komunikimet më të shpeshta/rralla me grupe shoqërore të ndryshme;
- h) Zbehja/forcimi e ndjenjës së bashkësisë;
- i) Liria individuale/varësia nga opinioni;
- j) Larmishmëria dhe intensiteti/monotomia i jetës social-kulturore dhe politike;
- k) Pasiguria dhe stresi/siguria dhe qetësia;
- l) Dobësimi/forcimi i ndërveprimit social.

2 pikë Nëse shkruan dy ndryshime ndërmjet mënyrës urbane dhe rurale të jetesës **OSE****1 pikë** Nëse shkruan saktë një ndryshim ndërmjet mënyrës urbane dhe rurale të jetesës**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

19. Model përgjigjeje:

Tipare të shtresimit shoqëror:

- a) është veçori e shoqërisë, pavarësisht nga vullneti i individëve të veçantë
- b) është i përgjithshëm, por me tipare të veçanta në çdo shoqëri
- c) vazhdon gjatë disa brezave/trashëgohet nga prindërit te fëmijët)
- d) mbështetet nga modele kulturore, nga bindje të natyrave të ndryshme

2 pikë Nëse shkruan dy tipare të shtresimit shoqëror**OSE****1 pikë** Nëse shkruan një tipar të shtresimit shoqëror**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

20. Model përgjigjeje:

- a) dobësimi i ndjenjës së kolektivitetit;
- b) individualizimi i mënyrës së jetesës;
- c) zbehja e lidhjeve emocionale;
- d) dobësimi i ndjenjës së identitetit dhe përkatësisë;
- e) dobësimi i kontrollit shoqëror;
- f) dobësimi i lidhjeve shoqërore;
- g) dobësimi i rolit të famijes dhe lidhjeve të gjakut;
- h) dobësimi i lidhjeve me fqinjët, etj.

2 pikë Nëse shkruan dy pasoja që sjell për shoqërinë moderne venitja e komuniteteve të vegjël tradicionale.**OSE****1 pikë** Nëse shkruan një pasojë që sjell për shoqërinë moderne venitja e komuniteteve të vegjël tradicionale.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare